

Gëzim Hajdari

Antologjia  
e shiut

Poezi

BIBLIOTEKA

8JH-1  
H 19

854-1

HIS

Gëzim  
Hajdari

Rezension

Rez. N. M. V.

Poet.

VITE II. NERI IHEM

АРДИС ОДРОВ

Antologjia  
e shiut

Poezi

Shtëpia botuese

«Naim Frashëri»



## VITE TË HERSHËM

KORI 174

Fëmijëri e largët,  
peligorgë – zogu im i shtrenjtë,  
plloskë e ujit të shiravë në strehë  
që e mbledhë nëna për të na lartë kokën me  
bot,  
fushë me vesërimë, ku shkoja herët në agim  
dhe gramafoni i vjetër (që ka heshtur) i  
përgjithmonë,  
çantë e librave të shkollës së fshatit,  
motive të dashurisë së shkuar,  
balada, këngë, dasma,  
fjalë të harruara...

s'mund t'ju harrøj dot aq lehtë.

## PĒRROI

ALLEGRI 31. 1974

Në një grusht rrëre, fëmijëria ime,  
s'të tretën dot ujërat e pérroi.

Mbi gur të bardhë gjurmët e hershme,  
pasqyruar te një vijez e ujit.

Buçimat e luta, ende më jehojnë,  
pérroi i shelgosur brigjesh.  
Përmbyt qasja rrjedhën ujra tëlliqetë,  
luginat – dekorime trille zogjsh.

Diku bregut tënd të dielave  
gratë lanin rroba përmbyt zallë,  
Deri në mbrëmje fushës dëgjohej  
zëri i ëmbël i peligorgave.

AU149323M 1131

Tani përroi i fëmijërise rrjedh nëpër mall, larg meje.  
Tiparet e tua janë të thjeshta,  
veç ca guaska e ca grushtë rëre.  
  
Atje janë të gjitha, rëra, mbi gurë  
te shtrati rrinë vitet dhe datat;  
veçse guaskat si vezë boshë kanë mbetur,  
u kanë fluturuar qiejve patat...

## TEK E NESËRMJA

Do më kërkosh në shtëpi,  
në fushë do të më gjesh,  
Do më kërkosh në ditët e shqetësuara,  
do të më gjesh nëpër ditët e bukurë.  
Rrugës së fshatit do më kërkosh,  
do më gjesh të dashuruar,  
Do më kërkosh sot,  
por unë kam ikur tek e nesërmja.

# KAVAKU

INTERVIEW WITH ALEXANDER KAVAKU

Kavaku  
me çerdhe, zogjsh  
përkulet sa majtas, djathtas  
fushës me erë.  
Nëse rrëzohet përtokë,  
përgjigjet për qindra jetë zogjsh të tjere...

## KUR PRES PRANVERËN

Po qe se vjen më parë te ti pranvera,  
në Kupas,  
më lajmëro  
të dal ta pres  
në kufijtë ku ndajnë në dy krahinat tonë.  
Nësë dëj jem atë mëngjes  
duke dëgjuar koncertet e Shtrausit,  
do t'i lë ato.

Do të vesh këmishën e kaltër  
me mëngë të shkurtra,  
të shkurtra  
e do të rend fushës  
duke fishkellyer një motiv të bukur,  
të bukur,

## MORAMAN

e do tē shihem nē kthjelltēsinē e pafundme  
tē ujëravé që rrjedhin,  
nē pasqyrat e pellgjëvë do shoh ikjen e reve,  
lejlekët nē qiel,

Do tē mbyll, sytë  
e do dëgjoj këngët e zogjve.  
Dhe ti atëherë s'do më njohësh,  
se unë jam berë njëqind here më i ri,  
edhe pse' pranvera më parë erdhi të ti në  
Kupas.

## GRAMAFONI

Hesht gramafoni i lënë në harresë  
dhe pllaka i është vjetëruar fare.

Këngë të preferuara më s'këndon,  
e ka mbuluar bari në strehë.

Më merr malli për këngët e hershme,  
kur e kurdiste babai në oborr.  
Po pllaka e zezë më s'rrotullohet,  
zemereku ka mbetur në la minor.

Reth tij mblidhej gjithë mëhallat,  
aty çlodheshin fshatarët çdo darkë.  
Potpuritë popullore përhapeshin  
deri në Shegas e Çanakaj, larg.

## MALCOLM LITTLE

U tret famat e bujshme le gramafonit,  
po zëri i tij mes njerëzve jehon.  
Një pikë strehës dimërore të rrjedhë  
dhe pllaka e vjetër prapë kumbon...  
...

...përveç qëndrimit  
e vir përgjithësia e fëmijëve rëqezë  
tomigj mëdha jep

...

## PËRTEJ KODRAVE

Përtej kodrave flenë retë e verës.  
Përtej kodrave e shkëlqen e lumenj.  
Përtej kodrave është Balaj.  
Janë dysy, si dy pritjet.

Përtej kodrave  
nëpër degët e hirta të ullinjve  
zgjohen agimet.

Përtej kodrave nis krahina jote...

## KUPASI<sup>I</sup>)

Kupasi,  
një kupëz bosh,  
një kupëz me trishtime,  
një kupëz me lot.

Ty dikur të vunë emrin Kupas,  
se sa një kupëz iti prodhoje;  
një kupëz me misër, një kupëz me grurë,  
në të lindja, jetq dhe vdekja ishte.

Më një kupëz mate shin të gjitha,  
dhe dielli me një kupëz matej;  
qielli, uji dhe gëzimet gjithashtu,  
dhe njeriu me një kupëz çmohej.

---

Kupasi – fshat në krahinën e Darsisë

Sinonim i jetës ishte një kupëz  
në kodrat dhe qielin e Darësë;  
Kur kupanjakasi kthehej nga qyteti,  
fëmijët e prisin në gjysmën e udhës.

Sot në muzeun e fshatit ruhen dy kupëza,  
një kupëz bosh, një kupëz me kokrra gruri.  
Kupëzëni bosh është la i gjyshi,  
kupëzën me kokrra gruri e mbushi i biri.

Prerje e vjetër e qytetit është së shumë  
distanca e gjatë që është emri i tij, që  
i përcaktojë vendlindjen e tij. Në qytetin e  
Dardanës, që është vendlindja e tij, është

Kryeqyteti i vjetër i qytetit të Dardanës

## DARSIANE

Darsiane e bukur,  
cipë mëngjesi;  
ke dy — tri pikë vese  
si nishane qelqi.

Përmbi pëlburën e hollë  
të bluzës sate  
gjelbërojnë grunjra,  
shtegtojnë muzgje.

E bukura, e plota,  
si hëna darsiane;  
e mira, e lehta,  
si një gjethë thane.

Dale, moj e bukur,  
para se tē vesh  
në kodrat e Balajt —  
rri tek kjo vjershë.

## VAJZAT E SHEZËS ZBRESIN NË QYTET

Vajzat e Shezës zbresin në qytet,  
veshur me kostumin e së dielës,  
me jaka të bardha,  
flokët krehur krejt ndryshe.

Me shaka  
    e të qeshura,  
pa gjeste e bujë  
    në sy të njerëzve,  
S'të kujtojnë ato aspak  
vajzat e dikurshme, të ndrojtura të Darsisë,  
çarçafin,  
    temenatë.

Kanë ardhur të blejnë një basmë të bukur  
për shoqen e tyre Fatmë,  
(që s'mundën ta gjenin në dyqanin e fshatit).

THE SPANISH IN OVAL

Pastaj ulen në kafe «Rinia», rivizitojnë antikën e kalasë së lashtë, dhe kur kthehen anës Shkumbinit për në Shezë, këndojnë këngë me zë të lehtë për shoqen e tyre Fatmë...

KUR ERDHE NË DARSI

Kur erdhe në Darsi,  
qielli i Darsisë ishte me re dhe zogj,  
netët ishin zgjatur nga pritja për ty,  
çerdhet e lejlekëve ishin po ato,  
getësira verore mbledhur në skaj,  
bari kishte humbur drejtqëndrimin.

Çdo gjurmë në rrugën me pluhur të fshatit  
më shëmbëllente me gjurmët e tua,  
krahina ime më dukej tjetër krahinë,  
qielli i saj tjetër qill,  
ajri si fryma jote,  
kur erdhe në Darsi...

## TANI JE PJESE E KRAHINES SIME

Tani je pjesë e krahinës sime,  
e dialektit të saj,

e thirrjes së përditshme nëpër shtëpi,  
e kodrës me grurë të njomë,  
e ullinjve tej në faqe.

Tani je pjesë e rezervuarëve me ujëra të kaltra  
në juglindje të krahinës,  
e gëzimit,

e dhimbjes  
dhe pjesë e folklorit të gjinkallave të verës.

## KUR TË VISH PRAPË

Kur të vish prapë,  
në Hajdaraj do të ketë ardhur pranvera  
me trillet e zogjve  
juginat do jehojnë nga ujërat që rrjedhin,  
me bar të blertë dojenë mbushur sheshet,  
vjershat me metafora të reja.

Kur të vish prapë,  
s'kam për të të njojur,  
dhe ti me siguri s'do jesh më ajo e ditëve  
më parë.

## VIAS I HAZETI KON

Pemët,

retë, tërë prozën e hirte të dimrit mi e vështroj gjatë; kam ditë të tëra që po tëmbajnë gojë;

Kur të vish prapë,

kemi mjaft gjëra për të thënë...

22

## SIPAS LEGJENDËS

Sa herë që vë këmbën përmbi ura,  
dridhemi për një çast tjetëri është gjithqë që  
më duket sikur rëndoja mbi strupin e tendifte  
të murosur përsëj gjallip dikur, që atjejë sëjn  
grua; (Dy qytetarët e tij janë të vranëzop është  
grua;

është

qytetarët e tij janë të vranëzop është gjithqë që  
më duket sikur rëndoja mbi strupin e tendifte  
të murosur përsëj gjallip dikur, që atjejë sëjn  
grua;

qytetarët e tij janë të vranëzop është gjithqë që  
më duket sikur rëndoja mbi strupin e tendifte  
të murosur përsëj gjallip dikur, që atjejë sëjn  
grua;

## PO TA DËRGOJ PËRGJIGJEN E LETRËS SATE

Si përgjigje të letrës sate do të dërgoj  
një pendë nga peligorga,  
një gjeth vjeshte që te këputai përoty,  
të qeshurat e mia që i mblohdha nëpër  
dy fjalë të pathëna rrugë,  
dhe shaminë e vogël të dorës,  
që e harrove tek unë kur ishe herën e  
fundit.

Po të dërgoj në përgjigjen e letrës sate,  
që ti kur t'i lexosh të gjitha këto  
të ndihesh e gëzuar.

## PYLLI I RRALLUAR

Mëngjesi zbardhur krejt nga **vesa**,  
ecnim rrugës së **pyllit pa njeri**.  
**Kundërmimi i gjethye të kalbura**  
fëmijërinë e hershme të zgjoi **ty**.

Mes degëve të dendura të bredhave  
e para ti e gjeje shtegun.

Ca gërma të gdhendur keq mbi trungje  
si mbishkrime të lashta kanë mbetur.

Si flokët e mi janë rralluar tani  
drurët e pyllit pa një fletë.  
Ty emocionet për vjeshtën t'u shuan  
dhe asnjë fjalë s'flet.

Drurë të téré që mungojnë,  
t'i i numëron në heshjtje, pa zë,  
Tiparet e tyre sjell ndër mend,  
si të njerëzve të afërt që sjanë më...

...zgjedhur që mundësohet, që  
atmosfëri shkallëzohet, që  
vazhdon qëndrueshmëri, që  
tuaqduhet, që do si qendruar, që

...të përcollin, që jenë të lindur që  
nëntor qëndrojnë, që  
të vjen, që nuk vjen, që

TRENA QË IKNI

OLGA LIPANI

Trena që ikni... S'juu dëgjoj dot fishkëllimën e  
shëndetit, që është vërtetë një shënuar i përgjithshëm.

Nuk ju shoh dót tek ikni fushës rëshumlbni në  
mbetenat e qytetit, nje tmegull të bardhë e b-

Më duket sikur mëqellin vetëm përgjegjësi e tij  
në këtij momenti, e që përfundon me një kërcësim që  
dëgjohet që i ka dhënë një përgjegjësi e shëndetit.

Ez i është kështu që

## EMRIN TËND

MINI SO ALIJRI

Emrin tënd tjetë jepet bën e lartë opozitën  
do t'i vërrugës nga erdhe,  
dhe kthesës ku shfaqë nga larg, që shkak  
dhe fluturës që kape duke ardhur monopatit,  
dhe zogut që pe në degën e plespit, që s'm  
dhe lëndinës ku shkele me sandalet verore,  
dhe liqenit që të pasqyroj flokët si nata...

Emrin tënd do t'i vë,

Vipasjed. Si bnut ës dëlej i lëap dhëmja  
 ja dhashë ballinë sheshevë, këtë e tëgët qëqën  
 la dhashë sëtye ëqeaneve, galaktikave.  
 La dhashë fytren të sotmes, së nesërmes,  
 la dhashë zërin vitezë qëshkuje që do vijnë.  
 La dhashë durat së dashurës, takës, bimëverit  
 la dhashë këmbëtë udhëve.

Nëpumur. Ëska jë shëriq tëmtojë  
 Dhe ndihem prapë vijzut që ës qëndruan sët  
 pak vetvete,  
 pak gjithësi. Nëpumur kemi fjalë  
 qëllia ësni titiqod ës bnut ës qëndruan  
 sët  
 mëkësiz që përfundon që  
 ës sëmës që ës

zëmët e...

## P U S I

SHKAPEN AL

Zbardh pusi i vjetër në fund të kopshtit,  
nëpër degët e shelgut zogjtë këndojnë  
porse s'tringëllon më lart e poshtë  
litqarjë holluar dikur nga duart ensime meje  
është këputur  
gjurmët përqark tij kanë humbur  
dhe rrugina që të conte aty ka zënë mëllaga.

Në fshat tani kemi çezma.  
Veçse në fund të kopshtit unë shkoj hera-  
-herës  
se mos më shfaqet si dikur  
në pasqyrën e ujit

fytyra e nënës.

## TI FUSHËS KE DALE

## THUROJ TAKUA

Si krejt papritur dimri  
në periferi u shfaq. Brymë që ra natën  
gdhiu si shkrim vrap. Gjethet dëglë boje i fshiu  
ngjëca, shiu, era; nuk nuk  
në funde rrugësh i mblodhi  
si pelerinëza të vjetër uara.  
Përqark qartesi, kuarc  
periferi të zhveshura.  
Ti fushës ke dalë  
me fytyra nga era.

## UJËRAT E DRINIT

IL FUSHEZ KE DAFE

Përgjakur ujërat e Drinit plak po vijnë prej  
bjeshkëve  
e sipër ujérash nxin fytyra e gjakësit të lbes si  
hije e mallkuar.

Klithin e klithin zogjtë e brigjeve të tij të truar,  
mes dhimbjesh ngrihen urat e mjeshtërve të  
vrarë

pas shpine në natën e errët.

Përgjakur ujërat e Drinit plak po vijnë prej  
epikës së lashtë,  
vrarë e prerë shtatë shpirtrash. E Drini plak  
ashtu në verbëri e gjen shtratin e tij të  
moçëm  
me ahe, pshëretima, eshtra të fisit tim.

Përgjakur ujërat e Drinit plak po vijnë kah  
moti.

## DO TË VIJNË MBRËMJET E VERËS

Do të vijnë mbrëmjet e verës  
me muzg, errësirë, xixëllonja e mister,  
dhe unë do të dal deri te kodra përballë  
fshatit,  
siç dal gjithnjë kur vijnë mbrëmjet e verës,  
do të eci më këmbë deri atje;  
për qetësinë e natës së simboleve do mendoj,  
do të mendoj për yjet në qiell, për qiellin vetë,  
pastaj do të mundohem të sjell ndër mend 150  
epitetet e Shelit për hënën,  
zogjtë e shpërfytyruar për një çast dhe  
grunjërat e pjekura,  
pastaj do të kthehem në shtëpi  
e do rikujtoj poetët e famshëm që lëvduan  
natyrën...

## MEDIOKRI PËR MEDIOKRIN

S'mbeti poet pa shkruar  
për mediokrin qoftë dhe një vjershë.  
Disa i botuan në gazeta, revista,  
të tjerë në libra poezish.

Me zyrtarin barkmadh ndonjëri  
mediokrin e kahasoi.  
Nga koka gjer te këmbët, si lumë,  
metafora, epitete i atribuoi,

Jeton në qytet mediokri,  
tha një lirik pa rezerva,  
dhe kur fryshtimi i shteron  
shkon në pyll bën kompresa.

Një poet i ri shkroi i bindur,  
mediokri këpucë me majë mban.  
Kundër perisit ai s'është,  
muzat e artit thellë i nderon.

...Sikur t'u shfaqej ai në çast,  
s'do pyesnin më si e qysh.  
Të gjallë atë do ta kryqëzonin  
mu në titullin e poezisë.

Dikush mediokrin e krahasoi  
dhe me Shvejkun topolak;  
veçse askush veten se quajti  
mediokër sadopak!

## MUZG VJESHTE

Muzg vjeshte.  
Në fushë qetësi.  
Veç një rosë në kallamishte  
si njollë e zezë.

Në plep  
ka ngecur një copë mjegull  
si shamia e Kallogresë.

## SYRI IM

Syri im – natë e errët  
ku flë vetëm ti.

Syri im – kopsht i gjelbër  
ku shëtit vetëm ti.

Syri im – dritare e hapur  
ku sheh vetëm ti.

Syri im – mol i ri  
kur ankorohesh vetëm ti.

## NË POGRADEC TE LASGUSHI

Në Pogradec kam ardhur.  
Moti me shi është. I përhimtë është dhe  
horizonë si në lirikat e tij.  
Dhe unë lagjeve të qytetit gjithë mëngjesin  
kërkoj të takoj Lasgushin.  
Ku të ketë shkuar vallë në këtë orë!  
Në shtëpinë e tij të dikurshme trokas –  
një pëllumb i bardhë, i trembur fluturon,  
midis gurëve të murit të jashtëm ka mbirë fiku  
i egër,

nëpër shkallë, ja, tek zbut heshtja...  
Më kot rri e pres, asnjeri s'më përgjigjet, si  
në poemat e humbura të Serembes.  
Do të ketë dalë, mendova me vete.  
– Nga liqeni do ta gjesh, – thanë fqinjët.  
Te liqeni shkoj ta kërkoj.

Në breg valët llokoçiten.

Pyes peshkatarët:

— Do të ketë shkuar nga pjesa tjetër e qytetit,  
te plepat me krilla...

Në pjesën tjetër të qytetit shkova,

gjithë ditën brodha...

Lasgushin askund s'e pashë,

Lasgushin takova.

## KËNGË PËR VETEN

Eci në rrugën e madhe. Në xhep pasaportën  
time mbaj  
me datën e lindjes e fotografinë e vogël  
lëshuar nga gjendja civile,  
me profile fushash, diejsh e stinësh të kohëve  
që jetojmë;  
përbaltem ugareve, më dhimbset dhe një  
kokërr gruri për mundimin që fsheh.  
Kam fytyrën time, zërin tim, emrin tim, lëvdoj,  
dashuroj, urrej;  
për ditën që më ikën pa e jetuar ndiej  
pendim,  
i njoh vrasësit e Hamletit, mallkimin e Kalit  
të Trojës e njoh;  
s'përkolem para perëndive mitike. Besoj te

SHENZHEN MFG. LTD.

Miq, ju lutem, nē mē doni vērtet,  
mos mē kērkoni tē jem ai qē s'jam —

Miq, ju lutem, në më doni vërtet,  
mos më kërkoni të jem ai që s'jam –  
pa parzmoren  
e armën time,  
si Patrokli.

## SHENJTÉRIMI I PYLLIT

E prenë pyllin dikur,  
ngritën me të faltore, teqe, manastire,  
shkruan pastaj mbi të «Biblën», «Kuranin» për  
besimtarët;  
me altare, ikona mbushën kishat për  
lehtësimin e shpirtrave të njollosur,  
benë kryqe e i vunë mbi varre të të vdekurve  
në emër të perëndisë.  
Pastaj mbi drurët e tij u ngrohën netëve  
shenjtorët,  
bënë edhe qivure ku mbyllën vetveten e jetën  
mëkatare nën dhe.  
Me lisin tënd, o pyll, gdhendën dhe dyert e  
xhamive e gjithë ngrehinave të shenjta,  
veç ta dëgjoje, sa herë që ato hapeshin e  
mbylleshin  
ditën e shërbesave,  
trishtueshëm vajtonte pylli.

THE REEFERSEN DE TIGER! DE TIGER!

E. merre malli  
p r gjelb rimin, shushur men, stuhit ,  p  
cic rim n e zogjve,  
arom n e barit , t livadheve  
e druvarin.

## NE RRËKEZËN QË RRJEDH SHPATIT

Në rrëkezën  
që rrjedh shpatit  
përkuemi e shuajmë etjen  
unë  
dhe një çift pöllumbash  
të dashruar.

## E SHKRUAR NË NJË MBRËMJE VJESHTË

Ike  
nën shiun vjeshtor  
me flokët e gjatë  
si një përrua.

Tani në kopsht  
ra mbrëmja.  
Në oborr qullet  
veç imazhi  
yt.

Qëndri i vjetër është  
minxhet e mëdha e po  
shtrihet qëllimi i dështit  
të vjetër qëndrit që

etruen e pellështit  
te rimbresin e bërturit  
te A. Liderosit. Tani  
jedqasë është i çelët qëndri

qëndri i vjetër është i dështit  
– qëndri i vjetër është i vjetrit  
qëndri i vjetrit. Qëndri i vjetrit  
i përfundon, qëndri i vjetrit është i vjetrit.

## SHPIRTI I DANTES ME SHOKË

Dhe aq e bukur s'qe,  
po e bëri përfytyrimi im,  
thosh Edgar Alan Poe  
për Virgjininë.

Ndaj dhe e quante  
si gratë e përmendura:  
herë Leonorë, Ani,  
herë Helenë, herë Anabel' Li.

Kështu mund të ketë ngjarë  
dhe me gratë e dëgjuara —  
Beatriçen, Fiametën, Laurën  
që dashuroi Dantja, Bokacio, Petrarka.

Ndoshta ndonjëra aq hyjnore  
s'do të ketë qenë mbi tokë,  
por ish i bukur e qiellor  
shpirti i Dantes me shokë.

## LEJLEKU I PETËFIT

Kur vjen ti, lejlek,  
te plepi para shtëpisë,  
Pëtefin më kuiton —  
birin e shtrenjtë  
të stepës maxhare,  
Se vetëm ti, aist<sup>1)</sup>) i dashur,  
në betejën e Transilvanisë  
mbi trupin e poetit  
qave...

---

1) aist — lejlek (Hungarisht)

## FËMIJËT E KOPSHTeve

Vjeshta erdh në oborr.

Shesheve

dalin dorë për dore

me bluza të bardha

(qëndisur me nga një pëllumb të kaltër)

e fytyra të brishta,

(krejtësisht të pafajme)

spërkatur me pak vjeshtë –

fëmijët e kopshteve

Vjeshta erdh në oborr.

## MOS HARRO TË VISH DITËN E VERËS

Mos harro të vish ditën e verës.  
Me fjongon e kuqe lidhi flokët e yerdhë –  
aromë jargavanësh prej viseve të jugut  
fushës e kodrës të vish.

Krejt e jona do të jetë ajo ditë –  
e gjelbër,  
e kaltër  
si pasqyra qiellore e syve të tua –  
perëndime muzgjesh që digjen.

Mos harro të vish ditën e verës.

Në gjysmën e rrugës unë do dal të të pres —

i qeshur,

i gëzuar

si pëllumbi në fluturimin e parë.

Nëse shpatit përpjetë do ladhesh shumë,

në dorë merri sandalet si bashkëfshatarët  
e mia darsiane,

freskohu te burimi,

(mos u tremb, aty do vijnë dhe çafkat,  
krillat)

çlodhu pak mbi barin e njomë,

me guralecë përzëre qyqen,

që trishton në gjineshtrën luleverdhë.

Mos harro tē vish ditën e verës.

Pulëbardhat klithin hareshëm në lumë,  
shelgjet janë mbushur gjelbërim;  
sipër ujërash tē kristalta kërcejnë peshqit,  
rrëkeza plot diell zbresin monopatit.

Mos harro tē vish ditën e verës.

Në gjysmën e rrugës unë kam dal po tē pres  
me zemrën time në pëllëmbë  
mbështjellë në një gjethë mani.

## MË PADITËN

Më paditën te lulet – ka bukurinë tonë, thanë  
lulet,

Më paditën te lumi – në dej i rrjedh, u  
përgjigji lumi,

Më paditën te të korrat – fytyrën e tij kemi,  
folën të korrat,

Më paditën te uji që pi – i dashruar veç  
me atë etje, pohoi uji,

Më paditën te ajri që thith – pluhur kundër-  
mimesh më ka,  
dëshmoi ajri,

Më paditën te urtësia e shekujve – pasqyrë  
e tij njihem, shkroi urtësia,

Më paditën te nata – qiri i fikur jam,  
psherëtiu nata.

Më paditën te një ligj i «shenjtë» – s'e zë  
mallkimi im,  
u ankuat ai ligj,

Më paditën pastaj te vdekja – hije e vdekur  
jam, qëshì vdekja.

anë e ngrënë

anë tregimisë

anë që vdekja  
vdekja vdekja

## KËRKESE

Arë, qëndrinë e bëj libe, bëj me jetën e  
më jep kallëzënje e artë, që mëndim e njo  
diellin e rrumbtë të pjekur,  
që mban gjallë ditën.

Luginë,  
më jep freskinë e përhershme,  
ujin e burimit që i zgjon  
rininë luleverdhës aty pranë.

Korije,  
më jep gjethet e blerta,  
zogun lirik që këndon  
për jetën që nuk vdes.

E pasi m'i keni dhënë tē gjitha:  
kallëzën e artë, diellin, freskinë,  
ujin e mburimit dhe zoqunë lirik,  
unë zgjedh gjethen e blertë  
e vë në ballë tē ditës.

## RAPSODI

Kur bie muzgu në Darsi  
kthehen në Balaj peligorgat.  
Rima nga këngët e tyre mbloqat  
rapsodi Shahin Balit përi vjershat.  
Peligorgën me balanjaken,  
oh, ai i dashuroi aq shumë;  
Kapituj me rima i dhuron ajo,  
për balanjaken ndenji pa gjumë.

Plot zogj të tjerë ka në Balaj,  
po më e shtrenjta është peligorga.  
Gjithë ditën këndon në qiel,  
në Balaj kthehet në orët e vona.

Gjer në Hajdaraj erdhi sot  
peligorga e Shahin Balit.  
Sonetat e para i dha në fushë,  
pastaj mori rrugën e kthimit.

Ai, peligorga, dhëv balanjakja,  
në Balaj jetojnë të tre tok.  
Ata të dy punojnë fushës,  
ajo këndon në horizont.

## TRYEZA E FSHATIT

Tryeza ime e fshatit, e qëndrueshme  
prej lisi ngai pylli iu çapokut, iu që qantik  
pa lustër, għendur shpejju lej shpejja, qidha  
me njëi sbishei boj, tēs-brazu eejnej penek.

Non ċeo ī-niex tēn-vjeti pērsipere, qie  
rri nē capi, tēkkodex, si qatherex, qidher  
Dikur mbi tēm minn ġlexova pēr-cherie, tēx-pareri  
għadha Uitmānni, Bajroni, Nerudenh, ja ne  
għidha net tēq-téra, pēru t'qis sur annej, let-er  
sé dashurës.

Kunnekk emm iġġib u idha jiddu, fejn  
Tek ajo tryez e thjeshtë fshati  
unē shkrova dhe vjershat e para

tē għażuara, tē trishta.

## NË FUSHËN E ZGJANËS

Në fushën e Zgjanës,  
poshtë në luginën me vjeshtë,  
shtrirë në tokën e korruri qysh herët  
përtypet i kau plak qetë-qetë.  
Përmbi brirët e mëdhenj, kurrizin e kuq  
një gardaltnë kareshëm cicëron.  
Hesht për caçaste, shpatullën lëviz  
e shpatit përballë tret vështrimin,  
se si demat e rinji plugojnë tokën e murrme.  
Pastaj qetë-qetë prapë përtypet,  
në fushën e Zgjanës,  
atje poshtë në luginën me vjeshtë.

## KËNGË

Unë  
ti  
dhe  
fusha.

(Është era  
ajo që vjen.)

Unë  
ti  
dhe  
fusha.

(Është bulku  
ai që këndon)

Unë  
ti  
dhe  
fusha.

Ti, befas,  
bëhesh pemë  
e gjelbër,  
e brisht.

Mes fushës  
hesht  
si  
qiparis.

## NGA SHËNGJINI

920 M.

Nga Shëngjini  
nesër do të ikim  
me një dhimbje të kaltër në gji.  
(Të përkohshme qofshin ndarjet.)  
Hareja johë e ditëve të shkuara  
do të trokasë neteve vone nëpër guaskat  
boshë,  
si në perrallat magjike,  
klithjet e pulëbardhave, pelikanëve;  
si jehona dō treten në funde horizontesh;  
kështjellat, vizatimet e fëmijëve,  
hapat tanë mbi rëren e lagur  
do t'i fshijë baticha e detit.  
  
Vetëm pylli do mbëtet  
dhe përplasjet e valëve në breg –  
rrokje blu të kripura.

## NESËR

O sa ftesa kam nesër  
nga një zog, nga një gjethë,  
nga një rrugë, nga një lule, nga një re.  
I gjeta në tryezën time të fshatit.  
Kish ardhë zogu e kish lënë këngën,  
kish ardhë gjethja e kish lënë blerimin,  
kish ardhë rruga e kish lënë ecjen,  
kish ardhë lulja e kish lënë aromën,  
kish ardhë reja e kish lënë shiun.

O sa të njoher më presin nesër,  
Më ftojnë dhe shokët, miqtë, të korrat,  
për në veri, për në jug, trenat  
dhe ylli i largët, dielli, krejt universi.

## PESHKATARI PLAK

Balli i tij, sytë e tij, duart e tij – kundërmim  
rrahur nga lërërat e Adriatikut, e donit,  
nga rrezet e diellit të jugut përzhitur,  
nga kripa e bardhë regjur e plasaritur.  
Rri e sjell ndërmend tanë në kopshtin e vogël  
gjithçka që iku e s'kthëhet më prapë.  
Jehona e viteve që ishkuan atje në det i  
kumbon në shpir.

Teksat malli e mëriopër peshkatevhën,  
kiçin, bashinte molini e vjetër, n'e bën  
kujton gjiret, nishujt e vetmuar; lagunat, ose  
godllat e anëdeteve, pulëbardhat, fikun e  
nërrjetë po detit, qefullin në rrjetë  
e trishtohet paksat, n'e zemrën atje në det i ka.

## ANTOLOGJIA E SHIUT

Pasi ia fala të gjitha «mëkatet»,  
një antologji desha t'i bëja shiut,  
që nga kohët më të lashta e deri tek më të  
rejat

si gjithë antologjitet e arteve të bukurë.

— Antologji për mua?! U çudit shiu.

— Fare thjesht, tha më në fund aspak i  
çuditur;

unë të jap faktet, përzgjedhjet bëji vetë.

Arën më të korrat e bollshme të parën

(se po të mos kisha breruar unë,  
ajo s'do të ish veçse shkretëtirë pa lule e

dashuri)

tjetër: dëtin më peshq, leshterikë e të tjera  
gjallesa,

(se po të mos ishin derdhur lumenjtë e mi,

ai s'do të ish veçse zgavër e stërmadhe e  
etur)

burrin e gruan, patjeten, si kryesorenë jetën  
(se shpesh pas çastitit të dashkuruar meaqi  
eshtë dashur një spikë për të freskuar)  
natyrish, që të dalë më e plot antologjia,  
shto këtu dhe yberin në horizont  
si një flamur në ditë festash.

## NJEREZORE

Pragmbrämje.

Jam ulur nē shkallaren e shtëpisë  
e rri.

Mbi kavak gumëzhijnë harabelat,

Nga larg vjen

këngane fqinjëve itë mi detarë, hija e pyllit,

zërat e fëmijëve.

Tuk-tuk godasin varkat me lopata peshkatarët  
Karavastasë.

Vallë c'është duke menduar ajo,  
nē këtë minutë, nē këtë çast?

Pragmbrämje.

Jam ulur nē shkallaren e shtëpisë  
e rri.

Mbi kavak gumëzhijnë harabelat.

## Ç'TË JEM?

AUT. L. A. J. S.

Pyes .. veten, ..... e ..... më ..... që ..... ç' ..... të ..... jem ..... në ..... këtë ..... minutë, ..... në ..... këtë ..... çast? ..... Det ..... me ..... shkumë ..... të ..... jesh, ..... më ..... thonë ..... deti, ..... lumë ..... që ..... rrjedh, ..... më ..... përgjigjet ..... lumi. ..... Ç'të ..... jesh ..... si ..... ky ..... shi, ..... që ..... bie ..... me ..... të ..... butë, ..... këtë ..... pragmbrëmje, ..... e ..... larg ..... nëpër ..... fshatra, ..... grurin ..... e ..... rrit, ..... më ..... flet ..... dita, ..... Pse ..... jo, ..... pasqyrë ..... e ..... kaltër, ..... më ..... dikton ..... stina. ..... Dua ..... të ..... iem, ..... rajo ..... pema ..... e ..... pjekur, ..... mes ..... arës, ..... që ..... kallon:

## PËRMBAJTJA

Vite të hershme .....	3
Përroi .....	4
Tek e nesërmja .....	6
Kavaku .....	7
Kur pres pranverën .....	8
Gramafoni .....	10
Përtej kodrave .....	12
Kupasi .....	13
Darsiane .....	15
Vajzat e Shezës zbresin në qytet .....	17
Kur erdhe në Darsi .....	19
Tani je pjesë e krahinës sime .....	20
Kur të vish prapë .....	21
Sipas legjendës .....	23
Po ta dëgjoj përgjigjen e letrës sate .....	24
Pylli i rralluar .....	25
Trena që ikni .....	27
Emrin tënd .....	28
Ia dhashë .....	29

Pusi .....	30
Ti fushës ke dalë .....	31
Ujërat e Drinit .....	32
Do të vijnë mbrëmjet e verës .....	33
Mediokri për mediokrin .....	34
Muzg vjeshte .....	36
Syri im .....	37
Në Pogradec te Lasgushi .....	38
Këngë për veten .....	40
Shenjtërim i pyllit .....	42
Në rrëkezën që rrjedh shpatit .....	44
E shkruar në një mbrëmje vjeshte .....	45
Shpirti i Dantes me shokë .....	46
Lejleku i Petëfit .....	48
Fëmijët e kopshteve .....	49
Mos harro të vish ditën e verës .....	50
Më paditën .....	53
Kërkesë .....	55
Rapsodi .....	57
Tryeza e fshatit .....	59
Në fushën e Zgjanës .....	60
Këngë .....	61
Nga Shëngjini .....	63
Nesër .....	64
Peshkatari plak .....	65
Antologjia e shiut .....	66
Njerëzore .....	68
C'të jem .....	69



**GËZIM HAJDARI:** Ka lindur më 1957 në fshatin Hajdaraj të Lushnjës. Shkollën e mesme të përgjithshme dhe të mesmen ekonomike i mbaroi po në Lushnjë. Punon pranë Degës së Librit të këtij qyteti. Ka mbaruar edhe studimet e larta me korrespondencë në I.L.P. «A. Xhvani» — Elbasan. (Dega Gjuhë-Letërsi).

Ka filluar të botojë në shtypin letrar që në vitin 1982.

Ky është libri i tij i parë.